

VENDIM
Nr.92, datë 3.2.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I AUTOSTRADËS
FUSHË-KRUJË-MILOT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i autostradës Fushë-Krujë-Milot.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, në masën që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 31 091 m² tokë/arë, e vlerësuar me 1320 lekë/m², me vlerë shpronësimi 41 040 120 (dyzet e një milion e dyzet mijë e njëqind e njëzet) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 41 040 120 (dyzet e një milion e dyzet mijë e njëqind e njëzet) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda muajit janar 2008.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE TË CILËT DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË
AUTOSTRADËS FUSHË-KRUJË-MILOT

Nr.	Emri	Sipërfaqja tokë arë	Çmimi l/m ²	Vlera në lekë
1.	Met Seferi	4 100	1320	5 412 000
2.	Ram Brahja	2 852	1320	3 764 640
3.	Taf Kasmi	1 751	1320	2 311 320
4.	Idriz Kasmi	4 791	1320	6 324 120
5.	Gjet Palaj	2 712	1320	3 579 840
6.	Pjetër Gjetani	7 498	1320	9 897 360
7.	Dervish Lama	1 938	1320	2 558 160
8.	Hamdi Lama	3 511	1320	4 634 520
9.	Hamit Lama	1 938	1320	2 558 160
	Shuma	31 091	1320	41 040 120

Vlera totale e këtij shpronësimi është 41 040 120 (dyzet e një milion e dyzet mijë e njëqind e njëzet) lekë.